



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:187036

Datë: 04.04.2022

Numri i dokumentit: 02878783

C.nr.1017/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Afijete Sada - Gllogjani, në çështjen juridike të paditësit S.D. nga fshati P., Komuna Gjakovës, përfaqësuar nga Prenk Pepaj, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave personale, vlera kontestit 11,707.30 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur me 23 nëntor 2021, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurës, me 04 prill 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit S.D. nga fshati P., Komuna Gjakovë dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit të ia kompensojë të ardhurat personale në shumën prej 11,707.30 euro (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatë euro e tridhjetë centë), e cila shumë i referohet shpenzimeve siç më poshtë vijojnë:

- Për ndryshimin në emër të obligimit në pagat neto, shumën prej 9,926.88 euro;
- Për ndryshimin në emër të tatimit në paga, shumën prej 665.58 euro;
- Për ndryshimin në emër të trustit pensional në paga, shumën prej 1,114.84 euro,

këto për periudhën 01 shtator 2018 deri me 30 shtator 2020, me kamatë ligjore prej 8% e cila rrjedhë nga data 23 nëntor 2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale, në lartësi prej 701.00 euro (shtatëqind e një euro) e këtë në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi me padi dhe gjatë shqyrtimit, përmes të autorizuarit të tij ka parashtruar padi me bazë juridike kompensim i të ardhurave personale. Paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në Shkollën e Mesme “H.” në Gjakovë, në punët dhe detyrat e punës së mësimdhënësit të gjuhës gjermane në kohë të pacaktuar. Me konkursin Zyrt. 01/188, të datës 19 korrik 2018 nga ana e të paditurës është shpallë vend i lirë i punës për mësimdhënësit të gjuhës gjermane, me 18 orë mësimi në javë. Në rastin konkret nga ana e të paditurës pa kurrfarë bazë është shpallur konkurs për vendin e punës për të cilin paditësi ka pas kontratë pune në kohë të pacaktuar. Nga kjo rrjedhë se i njëjti veprim i të paditurës ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Nga ana e të paditurës, paditësit nuk i është lëshuar asnjë vendim lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ku lidhur me të njëjtin rast paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë, për kthim në vendin e punës. Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.699/18, të datës 08 gusht

2019, është aprovuar kërkesëpadija e paditësit për kthim në vendin e punës së profesorit të gjuhës gjermane në Shkollën e Mesme "H." në Gjakovë. E paditura e ka kthyer paditësin në punë dhe detyrat e punës së profesorit të gjuhës gjermane, mirëpo nuk ja ka kompensuar të ardhurat personale për periudhën duke filluar nga muaji shtator 2018, e deri në ditën e kthimit në punë në muajin tetor 2020. Paditësi deri në momentin e kthimit në punë tek e paditura, ka realizuar të ardhura personale në shumë prej 480.00 euro në muaj. Lidhur me lartësinë e kompensimit e ka rezervuar të drejtën e precizimit, pas ekspertizës financiare.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimeve ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë parashtrimeve si në padi dhe kërkesëpadi, me propozim për gjykatën që të caktojë ekspertizë financiare.

Më tej ka shtuar se me kohë e ka pranuar ekspertizën e ekspertit, në të cilën nuk ka pasur vërejtje, ashtu që bazuar në të dhënat e saj, i njëjti e ka bërë precizimin e kërkesëpadiës si në vijim: për ndryshim në emër të obligimit në pagat neto, shumën prej 9,926.88€, për ndryshimit në emër të tatimit në paga shumën prej 665.58€ dhe për ndryshim në emër të trustit pensional në paga, shumën prej 1.114.84€, gjithsejtë shumën prej 11,707.30€ për periudhën 01 shtator 2018 deri me 30 shtator 2020 me kamatë ligjore prej 8% duke filluar 20 gusht 2021 (dita e ekspertizës), e deri në pagesën definitive.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se nga provat e administruara në këtë çështje juridike është vërtetuar themelësia e kërkesëpadiës së precizuar, meqenëse paditësi është larguar në mënyrë kundërligjore, respektivisht i është shkëputur marrëdhënia e punës, e në ndërkohë e paditura e ka kthyer në punë në detyrat e punës së mësimdhënës të gjuhës gjermane, me 01 tetor 2020 dhe atë në kohë siç është cekur në ekspertizë. Pra, për këtë arsye është kërkuar lartësia e kompensimit të ardhurave personale për periudhën e cekur si në parashtrësë, gjegjësisht diferenca në paga për periudhën kur paditësi ka punuar. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e precizuar e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 156.00 euro, për pjesëmarrje të autorizuarit në katër (4) seanca, shumën prej nga 13.00 euro respektivisht në shumë prej 640.00 euro, për ekspertizë shumën .00 euro si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 40.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 916.00 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 13 janar 2021 (për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta ka pranuar me po të njëjtën datë (13 janar 2021), siç vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës, mirëpo e paditura nuk ka parashtruar fare përgjigje në padi, përkundër obligimit ligjor.

Me propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, Gjykata shqyrtimin kryesor të treguar me datë 23 nëntor 2021 e mbajti në mungesë të të paditurës së ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: aktgjykimin C.nr.699/2018 të datës 08 gusht 2019, i formës së prerë nga data 27 shtator 2019, ekspertizës së ekspertit financiar K.Q. të datës 20 gusht 2021, listën e pagave të muajve korrik dhe gusht 2018, pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 01 korrik 2018, deri me datë 11 gusht 2021, monitorimin e transaksioneve të llogarisë e lëshuar nga TEB Bank, propozimin për përmbarim sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.699/2018, të datës 08 gusht 2019, parashtrësës së datës 25 nëntor 2020, me numër të lëndës CP.nr.402/19, si dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, CP.nr.409/2019, datë 20 gusht 2020, ku pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe duke u bazuar në lidhshmërinë e tyre reciproke, në kuptim të nenit

8 të LPK-së, vërtetojë se kërkesëpadia e precizuar e paditësit, është në tërësi e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike si në vijim:

Me aktgjykimin e kësaj Gjykate, me nr. punues C.nr.699/2018, të datës 08 gusht 2019, i formës së prerë nga data 27 shtator 2019, provohet rrethana se është aprovuar kërkesëpadia e paditësit S.D. nga fshati P., Komuna Gjakovë dhe është detyruar e paditura Komuna Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, që paditësin t'a kthejë në punë në detyrat e punës së profesorit të gjuhës gjermane në Shkollën e Mesme "H." në Gjakovë.

Nga propozimi për përmbarrim sipas aktgjykimit të lartcekur të kësaj gjykate C.nr. 699/2018, datë 09 dhjetor 2019, vërtetohet fakti se i autorizuari i kreditorit (këtu paditësit) ka parashtruar propozim në këtë gjykatë, ndaj debitorit (këtu të paditurës) që të lejohet përmbarrimi në bazë të vendimit të lartcekur, duke e detyruar kreditorin t'a kthejë në punë në detyrat e punës së profesorit të gjuhës gjermane, në shkollën "H." në Gjakovë.

Nga Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, CP.nr. 409/2019, datë 20 gusht 2020, është vërtetuar rrethana se debitori (këtu e paditura) është detyruar që në afatin prej 3 ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimi ta zbatoj me përpikëri aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr. 699/2018, datë 08 gusht 2019, i formës së prerë nga data 27 shtator 2019, i ekzekutueshëm nga 08 tetor 2019, ashtu që kreditorin (këtu paditësin) t'a kthejë në punë dhe detyrat e punës së profesorit të gjuhës gjermane në Shkollën e Mesme "H." në Gjakovë, duke e detyruar të ia paguajë edhe borxhin në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në vlerë prej 490.00 euro.

Me parashtrësën e datës 25 nëntor 2020, me numër të lëndës CP.nr.402/19, vërtetohet se i autorizuari i kreditorit (këtu paditësit) ka parashtruar kërkesë në këtë gjykatë duke kërkuar nga gjykata që t'a detyrojë debitorin këtu të paditurën, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të ia paguajë shumën prej 490.00 euro, duke shtuar se debitori pjesërisht e ka përmbushë detyrimin sipas Aktvendimit CP.nr.402/19, e ka kthyer kreditorin në punë, mirëpo deri në momentin e parashtrimit të kësaj parashtrëse nuk ja ka paguar të njëjtit shumën në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Sipas listës së pagave lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, që i referohet muajit korrik 2018 vërtetohet se paditësi ka realizuar pagë neto mujore në vlerë prej 47.19 euro, apo bruto në vlerë prej 53.26 euro, po ashtu nga lista e pagave e muajit gusht 2018 vërtetohet se paditësi ka realizuar pagë neto mujore në vlerë prej 473.19 euro, apo bruto në vlerë prej 530.26 euro

Me pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 01 korrik 2018, deri me datë 11 gusht 2021, vërtetohet se bilanci përfundimtar i kontributeve arrin vlerën prej 1,793.3236.

Nga monitorimi i transaksioneve të llogarisë e lëshuar nga TEB Bank me datë 01 janar 2021 deri më 17 dhjetor 2018 vërtetohet pagat që ka realizuar paditësi në NSH . . .në Gjakovë që në mënyrë të detalizuar janë paraqitur nga ana e ekspertit në ekspertizë.

Eksperti financiar K.Q., ekonomist i diplomuar me ekspertizën financiare të formës së shkruar të datës 20 gusht 2021, ka vërtetuar rrethanat se në rastin konkret ekspertiza ka shqyrtuar këto pika: llogaritjen bruto të pagës nga data 01 shtator 2018 deri me datë 30 shtator 2020; llogaritjen neto të pagës nga data 01 shtator 2018 deri me datë 30 shtator 2020; llogaritjen e trustit pensional

në paga për periudhën nga data 01 shtator 2018 deri me datë 30 shtator 2020, si dhe llogaritjen e tatimit në paga për periudhën nga data 01 shtator 2018 deri me datë 30 shtator 2020. Realizimin e të ardhurave personale nga burimet tjera, jo nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjakovë (këtu e paditura). Gjatë periudhës nga data 01 shtator 2018 deri me 30 shtator 2020, paditësi ka realizuar të ardhura personale jo të rregullta mujore nga . . .O.P si dhe nga Ministria e Financave. Të ardhurat e realizuara janë si në vijim: 1. Pagesa Bruto Pagesë për periudhën: 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 432.00 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 shuma prej 1,117.00 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020 shuma prej 557.60 euro; 2. Pagesa Neto Pagës për periudhën: 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 403.12 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, shuma prej 1,039.29 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020, shuma prej 519.96 euro; 3. Pagesa e tatimit në paga për periudhën 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 7.28 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 shuma prej 21.87 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020, shuma prej .77 euro; 4. Pagesa e trustit pensional në paga për periudhën 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 43.20 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 shuma prej 111.70 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020, shuma prej 55.76 euro. Në rastin konkret përfshihet shuma e të ardhurave personale që do të kishte realizuar paditësi nga e paditura, ashtu që S.D. duke u mbështetur në listat e pagave mujore, gjegjësisht muaji korrik dhe gusht 2018, ku vërehet se bruto paga është në shumë prej 530.26 euro, gjatë periudhës nga data 01 shtator 2018 deri me 30 shtator 2020, do të kishte realizuar të ardhurat personale si në vijim: 1. Pagesa Bruto Pagesë për periudhën: 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 2,121.04 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, shuma prej 6,363.12 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020, shuma prej 4,772.34 euro; 2. Pagesa Neto Pagesë për periudhën: 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 1,902.28 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, shuma prej 5,706.84 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020 shuma prej 4,280.13 euro; 3. Pagesa e tatimit në paga për periudhën 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018, shuma prej 112.72 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 shuma prej 338.16 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020, shuma prej 253.62 euro; 4. Pagesa e trustit pensional në paga për periudhën 01 shtator 2018 – 31 dhjetor 2018 shuma prej 212.08 euro; 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019 shuma prej 636.24 euro; 01 janar 2020 – 30 shtator 2020 shuma prej 477.18 euro. Nga të lartcekurat eksperti në fjalë në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura ka nxjerrë konkluzë se këtu paditësi për periudhën 01 shtator 2018 - 30 shtator 2020, kërkon ndryshimin në emër të obligimit në pagat bruto, shumën prej 11,150.50 euro. Po ashtu në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura del se paditësi S.D., për periudhën 01 shtator 2018 - 30 shtator 2020, kërkon ndryshimin në emër të obligimit në pagat neto, shumën prej 9,926.88 euro. Në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura del se paditësi për periudhën 01 shtator 2018 - 30 shtator 2020, kërkon ndryshimin në emër të tatimit në paga shumën prej 665.58 euro si dhe në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura del se paditësi, për periudhën 01 shtator 2018 - 30 shtator 2020, kërkon ndryshimin në emër të trustit pensional në paga shumën prej 1,114.84 euro.

Gjatë vitit 2018 paditësi tek . . .në Gjakovë ka realizuar gjatë muajit tetor të ardhurat bruto në shumë 72.00 euro, kontributi nga punëtori 3.60 euro, kontributi nga punëdhënësi 3.60 euro, gjithsejtë kontribute 7.20 euro, të ardhurat e tatueshme 68.40 euro, paga neto 68.40 euro gjatë muajit nëntor 2018 ka realizuar të ardhurat bruto 192.00 euro, kontributi nga punëtori 9.60 euro, kontributi nga punëdhënësi 9.60 euro, gjithsejtë kontributet 19.20 euro, të ardhurat e tatueshme 182.40 euro, taksa 4.10 euro, paga neto 178.30 euro, muajin dhjetor 2018 të ardhurat bruto 168.00 euro, kontributi nga punëtori 8.40 euro, kontributi nga punëdhënësi 8.40 euro, gjithsejtë kontributet 16.80 euro, të ardhurat e tatueshme 159.60 euro, gjithsejtë taksat 3.18 euro, paga neto 156.42euro, në total punëtori –paditësi ka realizuar gjatë vitit 2101 të ardhurat bruto për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2018 shumën 432.00 euro, kontributi nga punëtori 21.60 euro,

kontributi nga punëdhënësi 21.60 euro, gjithsejtë 43.20 euro, të ardhurat e tatueshme 410.40 euro, gjithsejtë taksat 7.28 euro, paga neto 403.12 euro.

Gjatë vitit 2019 paditësi ka realizuar të ardhurat bruto gjatë muajit janar 61.00 euro, kontributi nga punëtori 3.05 euro, kontributi nga punëdhënësi 6.10 euro, gjithsejtë kontributet 6.10 euro, të ardhurat e tatueshme 57.95 euro, paga neto 57.95 euro, gjatë muajit mars 144.00 euro, kontributi nga punëtori 7.20 euro, kontributi nga punëdhënësi 7.20 euro, gjithsejtë kontributet 14.40 euro, të ardhurat e tatueshme 136.80 euro, gjithsejtë taksat 2.27 euro, paga neto 134.53 euro, gjatë muajit prill 2019 të ardhurat bruto 96.00 euro, kontributi nga punëtori 4.80 euro, kontributi nga punëdhënësit 4.80 euro gjithsejtë kontributet 9.60 euro, të ardhurat e tatueshme 91.20 euro, gjithsejtë taksë 0.45 euro, paga neto 90.75 euro, gjatë muajit maj 2019 të ardhurat bruto 144.00 euro, kontributi nga punëtori 7.20 euro, kontributi nga punëdhënësit 7.20 euro gjithsejtë kontributet 14.40 euro, të ardhurat e tatueshme 136.80 euro, taksat 2.27 euro paga neto 134.53 euro, gjatë muajit tetor 2019 të ardhurat bruto 144,00 euro kontributi nga punëtorit 7.20 euro, kontributi nga punëdhënësit 7.20 euro gjithsejtë kontributi 14.40 euro te ardhurat e tatueshme 136.80 euro, gjithsejtë taksë 2.27 euro, paga neto 134.53 euro, gjatë muajit nëntor 2019 të ardhurat bruto 240.00 euro, kontributi nga punëtori 12.00 euro, kontributi nga punëdhënësit gjithsejtë kontributet 24.00 euro, të ardhurat e tatueshme 228.00 euro gjithsejtë taksë 5.92 euro, paga neto 222.08 euro, gjatë muajit dhjetor 2019 të ardhurat bruto shuma 288.00 euro, kontributi nga punëtori 14.40 euro, kontributi nga punëdhënësit 14.40 euro, gjithsejtë kontributet 28.80 euro, të ardhurat e tatueshme 273.60 euro, taksat 8.69 euro paga neto 264.91 euro gjithsejtë gjatë vitit 2019 të ardhurat bruto në shumë prej 1,117.01 euro, kontributet nga punëtori 55.85 euro, kontributet nga punëdhënësi 55.85 euro, gjithsejtë kontributet 111.70 euro, të ardhurat e tatueshme 1.061.60 euro, gjithsejtë taksat 21.87 euro, paga neto 1,039.29 euro.

Gjatë vitit 2020, muajit janar të ardhurat bruto 144.00 euro, kontributi nga punëtori 7.20 euro kontributi nga punëdhënësi 7.20 euro gjithsejtë 14.40 euro, të ardhurat e tatueshme 136.80 euro gjithsejtë 2.27 euro, paga neto 134.53 euro, muaji shkurt 2020, të ardhura bruto 48.00 euro, kontributi nga punëtori 2.30 euro, kontributi nga punëdhënësi 2.40 euro, gjithsejtë kontributet 4.80 euro, të ardhurat e tatueshme 45.60 euro, paga neto 45.60 euro, gjatë muajit mars 2020 të ardhurat bruto 182.80 euro, kontributi nga punëtori 9.14 euro, kontributi nga punëdhënësit 9.14 euro gjithsejtë kontributet 18.28 euro, të ardhurat e tatueshme 173.66 euro, gjithsejtë taksë 3.75 euro, paga neto 169.91 euro, gjatë muajit prill 2020. të ardhurat bruto 182.80 euro, kontributi nga punëtori 9.14 euro, kontributi nga punëdhënësit 9.14 euro gjithsejtë kontributet 18.28 euro, të ardhurat e tatueshme 173.66 euro, gjithsejtë taksë 3.75 euro, paga neto 169.91 euro, gjithsejtë për muajt janar, shkurt, mars prill 2020 paditësi ka realizuar paga bruto tek Kolegji "U." në Gjakovë në shumë prej 557.61 euro, kontribute nga punëtori 27.88 euro, kontributet nga punëtori 27.88 euro gjithsejtë kontributet 55.76 euro, të ardhurat e tatueshme 529.73 euro, gjithsejtë taksë 9,77 euro, paga neto 519.96 euro.

Nga të lartë cekurat eksperti në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura ka nxjerr konkluzë se këtu paditësi për periudhën 01 shtator 2018 deri me 30 shtator 2020 ndryshimi në emër të obligimit në pagat bruto, është në shumë 11,150.50 euro. Po ashtu në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura del se paditësi për periudhën 01 shtator 2018 deri 30 shtator 2020 ndryshimi në emër të tatimit në paga shumën 665.58 euro si dhe në bazë të shënimeve të prezantuara dhe të llogaritura del se paditësi, për periudhën 01 shtator 2018 deri me 30 shtator 2020 ndryshimi në emër të trustit pensional në paga është shuma 1,114.84 euro. Eksperti ekspertizën e tij e ka përpiluar në mënyrë profesionale, gjithëpërfshirëse dhe gjykata të njëjtës ia fali besim e plotë. Për më tepër të paditurës i është proceduar kjo ekspertizë më kohë (siç

vërtetohet nga flete kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës dhe e njëjta nuk ka dhënë vërejtje më shkrim, çka rezulton se është pajtuar me përmbajtjen e ekspertizës.

Baza juridike e kërkesë padisë mbështet në Aktgjykimin e kësaj Gjykate C.nr. 699/18 datë 08 gusht 2019, i plotfuqishëm nga data 27 shtator 2019, me të cilin është detyruar e paditura që paditësin të e kthejë në punë. E paditura paditësin e ka kthyer në punë me datë 30 shtator 2020. Nga data e largimit të jo të ligjshëm nga puna për periudhën 01 shtator 2018 deri me rastin e kthimit në punë të paditësit (30 shtator 2020) paditëset i takon kompensimi i kërkuar bazuar në nenin 80 të Ligjin e Punës me të cilën dispozitë është para parë se: Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është jo ligjore, në bazë të dispozitave të këtij Ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutojë njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1 të i paguajë të punësuarave kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate. Me aktvendimin CP.nr. 409/19 të datës 08 gusht 2019 gjykata ka detyruar të paditurën për kthimin e paditësit në punë dhe detyrat e punës së profesorit të gjuhës gjermane në Shkollën e Mësim “H. “ në Gjakovë e që e paditura, paditësin e ka kthyer në punë me datë 30 shtator 2020 dhe për këtë paditësit sipas nenin 80 paragrafi 1.1.2 të njëjtit Ligj nëse largimi është vlerësuar si i paligjshme paditësi ka të drejtën në kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

Gjykata aprovoj në tërësi kërkesë padinë precizuar të paditësit si të bazuar në shumat e kompensimit të pagave të plota dhe të diferencës në paga gjatë periudhës sa ka punuar të përshkruara më detalisht si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditori, përkatësisht këtu paditësit në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë së precizuar si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, tutje paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, andaj meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në kompensimin e obligimit sa i përket kompensimit lidhur me kompensimin e të ardhurave personale, që ka pasur ndaj këtu paditësit, gjykata vlerëson së përpos kërkesës kryesore, paditësit i takon edhe kamata e gjykuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç’rast paditësit iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 40.00 euro, për përpilimin e padisë shumë prej 156.00 euro si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësit për dy seanca të plota seanca të plota (135.00 euro x2) shuma prej

270.00 euro, dy seanca nga 50% (67.50x2) shuma 135.00 euro përpilimin e ekspertizës shumë prej 100,00 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 701.00 euro ashtu që në pjesën tjetër shpenzimet për përfaqësim në dy seanca u refuzuan për shkak të precizimit të kërkesëpadisë në shqyrtim dhe një seance të shtyrë.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm,
C.nr.1017/20, me 04 prill 2022

Gj y q t a r j a,
Afijete Sada - Gllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate